Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Bekim Shabani	**15.10.2026**	**26.10.2026**	**2026/0784**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.10.2026, OE “" EJONA " SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0784, Njoftimit mbi Vendimin B58 i publikuar nga Autoritetit Kontraktues me të cilin vendim AK ka rekomanduar për Kontratë Operatorin Ekonomik CTA SH.P.K, Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Blerja dhe montimi i pompes termike per administrate” me nr. të prokurimit: "635-26-7196-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Punë.

Vlera e parashikuar e kontratës 260,239.80 €.

Konform nenit 113,114 të Ligjit Nr.04/L-042, i plotësuar dhen dryshuar me Ligjin 04 / L-237, Ligjin 05 / L-068, dhe Ligjin 05 / L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues, dokumentacionin e tenderit dhe shkresat tjera relevante të administruara në këtë procedurë.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Pretendimet nga OE Ankues:

Konsiderojme se jane shkele keto nene te Rregullores se Udhezuesit Operativ te Prokurimit Publik: Neni 7 i LPP-së - barazia në trajtim dhe mosdiskriminimi. Neni 59 i LPP-së - ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve sipas DT-së. Neni 60 i LPP-së - dhënia e kontratës tenderit të përgjegjshëm sipas kriterit të përcaktuar. Neni 69 i LPP-së - aftësia teknike dhe profesionale. Neni 72, veçanërisht paragrafi 3, i LPP-së - kufijtë e sqarimit dhe plotësimit të dokumenteve. Neni 108/A, paragrafët 9 dhe 12, i LPP-së - detyrimi për vendim të arsyetuar në procedurën paraprake. Neni 40.2 dhe paragrafët 40.6-40.8 të Rregullores për Prokurimin Publik - vlerësimi sipas DT-së, devijimet materiale dhe ndalimi i ndryshimit të një aspekti material përmes sqarimit. Nga refuzimi i Kërkesës për Rishqyrtim kemi shkelje të këtyre dispozitave: Neni 108/A, paragrafi 6 – e obligon AK-në ta shqyrtojë kërkesën për rishqyrtim. Neni 108/A, paragrafi 9 – refuzimi duhet të jetë i arsyetuar dhe t'i komunikohet ankuesit. Neni 108/A, paragrafi 12 – vendimi për refuzimin ose miratimin e kërkesës duhet të jetë i arsyetuar.

1. **CTA SH.P.K. –** OE i rekomanduar për kontratë Pretendimet kryesore 1. Mungojnë katalogët për pajisjet përcjellëse (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) CTA ka dorëzuar katalog për pompat termike Haier, por nuk janë gjetur katalogë ose fletë teknike zyrtare për pajisjet përcjellëse të ofertës, si pompat qarkulluese, akumulatorët, enët ekspanduese dhe pajisjet e tjera relevante. Kërkesa 5 nuk kufizohet vetëm te pompa termike, por kërkon katalog edhe për pajisjet përcjellëse. sipas pozicioneve relevante të paramasës: pompat qarkulluese; akumulatorët e nxehtësisë; enët ekspanduese; valvulat dhe pajisjet e tjera të kontrollit; pajisjet e tjera përcjellëse për të cilat kërkohet identifikimi i prodhuesit, markës, modelit dhe karakteristikave teknike.

Kërkesa 5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalogun ose fletën teknike të prodhuesit për pompën termike dhe pajisjet përcjellëse të ofruara, me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Katalogu fleta teknike duhet të përmbajë së paku emrin e prodhuesit, markën, modelin, kapacitetin, karakteristikat teknike, efikasitetin energjetik dhe të dhënat e tjera relevante të pajisjes së ofruar.	**Dëshmia 5 Operatori Ek dorëzojë Katalogun, prosp teknike zyrtare të prodhues termike dhe pajisjet përcjel Dokumenti duhet të identifi prodhuesin, markën dhe m katalog fletën teknike duhe nënvizohen qartë karakteri dëshmojnë përputhshmërin Dosjes së Tenderit; Dokum paraqitet në gjuhën shqipe origjinale, i shoqëruar me p shqipe për pjesët relevante.**


2. Katalogu nuk është përkthyer në shqip (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) Katalogu Haier është në gjuhën angleze dhe nuk është shoqëruar me përkthimin në shqip të pjesëve relevante, siç kërkohet shprehimisht nga Dëshmia 5.

3. Karakteristikat relevante nuk janë shënuar/nënvizuar qartë 5/11 Në katalog nuk janë identifikuar në mënyrë të qartë të gjitha karakteristikat që dëshmojnë përputhjen me specifikimet e AK-së.

4. Mungon dëshmia e lidhjes ndërmjet Haier-it dhe EngOffice (për këtë pretendim AK ka thënë se duhet të verifikohet) Autorizimi është lëshuar nga EngOffice. Nuk është dorëzuar dokumenti nga prodhuesi Haier që dëshmon se EngOffice është distributor ose përfaqësues i autorizuar i prodhuesit. Kjo nuk e përmbush plotësisht Dëshminë 6, e cila kërkon edhe dëshminë e marrëdhënies distributor–prodhues.

Kërkesa 6 Autorizimi nga prodhuesi Operatori Ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi i pompës termike të ofruar ose nga përfaqësuesi distributori i autorizuar i prodhuesit, për ofertimin, furnizimin, montimin dhe ofrimin e garancisë dhe servisit për pajisjen përkatëse.	**Dëshmia 6 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë ,Autorizim të vlefshëm nga prodhuesi i pompës termike; ose Autorizim nga përfaqësuesi distributori i autorizuar, i shoqëruar me dëshmi që vërteton lidhjen e tij me prodhuesin. Autorizimi duhet,Të jetë lëshuar në emër të Operatorit Ekonomik ofertues;Të identifikojë prodhuesin, markën dhe, sipas mundësisë, modelin e pajisjes së ofruar; T'i referohet aktivitetit të prokurimit "Blerja dhe montimi i pompës termike për administratë", duke përfshirë numrin e prokurimit**

5. Inxhinieri nuk ploteson kriterin 3 vite pervoje pune CTA SH.P.K. për Kërkesa 3 : "inxhinier i diplomuar i Termoteknikës, me minimum 3 vite përvojë pune". ka dorëzuar dokumentet e inxhinierit Ilir Elezaj i cili nuk posedon së paku tri vite përvojë profesionale relevante pas fitimit të kualifikimit përkatës (Inxhinier i makinerisë). Diploma e dorëzuar dëshmon se Ilir Elezaj i ka përfunduar studimet në programin Termoenergjetikë dhe Termoteknikë më 4 dhjetor 2025. Deri në afatin për dorëzimin e tenderëve, më 15 shtator 2026, nga diplomimi kishin kaluar vetëm rreth nëntë muaj.



FAKULTETI I INXHINIERISE MEKANIKE NË PRISHTINË

FACULTY OF MECHANICAL ENGINEERING IN PRISHTINA

Diplomë Diploma

ILIR SHAQIR ELEZAJ

U lind më 19.08.1994 në Pejë.	Born on 19.08.1994 in Pejë.
U regjistrua në vitin akademik 2023/2024 në studimet master.	Was enrolled in the academic year 2023/2024 in master studies.
Studimet i mbaroi me 4 dhjetor 2025.	Completed his/her studies on 4 December 2025.
Gjithsej 120 pikë - ECTS	Total ECTS 120
Nota mesatare gjatë studimeve 7,75	Average grade of studies 7,75
E mbrojti me sukses temën e masterit:	Defended his/her Master Thesis:
Projektimi i sistemit të gazrave medicinal për spitalin e Ferizajt	Design of medical gases hospital of Ferizaj

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar angazhimin e një inxhinieri të diplomuar –(e jo Bachelor të inxhinierisë), me së paku tri (3) vite përvojë profesionale. Meqenëse titulli dhe kualifikimi i kërkuar shprehimisht është Inxhinier i Makinerisë, përvoja relevante për përmbushjen e këtij kriteri duhet të llogaritet nga data kur personi e ka fituar këtë titull akademik. Titulli Inxhinier i Makinerisë fitohet pas përfundimit të studimeve Master sipas sistemit te Bolonjes, ose sipas sistemit të vjetër që nuk kishin nevojë ta kryenin veçmas Masterin për ta fituar titullin "inxhinier i diplomuar". Ndërsa me logjikën e AK se përvoja njifet edhe para përfitimit të titullit inxhinier,

kështu do mund të vlente edhe përvoja e mëparshme kur individi nuk ka qenë as në fakultet dhe pa asnjë aftësi profesionale.

2.**Grupi i OE EKOTERMIKA SH.P.K. & HARST Group SH.P.K**. 1. Mungojnë katalogët për pajisjet përcjellëse (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) Dokumentacioni teknik përmban katalogun Haier për chiller-at, por nuk janë gjetur katalogë ose fletë teknike zyrtare për pajisjet përcjellëse të ofertës, si pompat qarkulluese, akumulatorët, enët ekspanduese dhe pajisjet e tjera relevante. Kërkesa 5 nuk kufizohet vetëm te pompa termike, por kërkon katalog edhe për pajisjet përcjellëse sipas pozicioneve relevante të paramasës: pompat qarkulluese; akumulatorët e nxehtësisë; enët ekspanduese; valvulat dhe pajisjet e tjera të kontrollit; pajisjet e tjera përcjellëse për të cilat kërkohet identifikimi i prodhuesit, markës, modelit dhe karakteristikave teknike.

2. Katalogu është vetëm në anglisht (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) Pjesët relevante të katalogut Haier nuk janë shoqëruar me përkthim në shqip.


3. Paqartësi rreth modelit të ofertuar - VARIANT Në katalog dhe autorizim paraqiten disa modele, përfshirë: CA0070HANH; CA0100HANH; CA0140HANH; ? modele të tjera të serisë EAND. OE në katalog ka nënvizuar edhe modelin CA0140HANH duke tentuar kështu të ofrojë variante për AK dhe duke krijuar pasiguri në produktet e ofertuara. Gjë që e bën automatikisht ofertën variant, dhe variantet janë të papranueshme nga AK në këtë DT.


Haier

SPECIFICATIONS

4. Mungon dëshmia e marrëdhënies Haier–EngOffice Autorizimi është lëshuar nga EngOffice, por nuk është gjetur dokument zyrtar nga Haier që dëshmon statusin e EngOffice si distributor/përfaqësues i autorizuar.

3. **2B ENGINEERING SH.P.K**. 1. Pretendimet ne vazhdim : mospërputhje teknike e produktit Midea (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) 2B ka nënvizuar modelet: MH-SU75-RN8L; ? MH-SU110-RN8L. Katalogu zyrtar përcakton: Karakteristika Kërkesa e AK-së Katalogu Midea Funksionimi në ftohje –20°C deri +53°C –15°C deri +48°C Funksionimi në ngrohje –25°C deri +50°C –25°C deri +43°C Pra, pajisja Midea: nuk punon deri në –20°C në ftohje; nuk punon deri në +53°C në ftohje; nuk punon deri në +50°C në ngrohje.




Kjo është mospërputhje materiale që del drejtpërdrejt nga katalogu i vetë OE-së. Pra, produktet e ofertuara nuk plotësojnë kërkesat minimale të specifikimit teknik.

2. Mungon përkthimi në shqip (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) Katalogu është në anglisht dhe nuk përmban përkthimin në shqip të pjesëve relevante. Poashtu edhe per katalogjet e kerkuara tek kerkesa 5 ku kerkohen katalogjet teknike per te gjithe pozicionet percjellese, OE ka prezentuar vetem disa prej tyre dhe jo komplet.

4. **ADETEX SH.P.K.** 1. Mungon modeli për kapacitetin 65/71 kW (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) Në paramasën e objektit të Kadastrës është kërkuar një pompë termike me kapacitet ftohës 65 kW dhe kapacitet ngrohës 71 kW. Sipas Kërkesës 5 dhe Dëshmisë 5, operatori ekonomik ka qenë i obliguar të dorëzojë katalogun, prospektin ose fletën teknike zyrtare të prodhuesit, në të cilën duhet të identifikohen qartë: prodhuesi;marka;modeli konkret i pajisjes së ofruar;kapaciteti ftohës dhe ngrohës;karakteristikat teknike;efikasiteti energjetik;karakteristikat që dëshmojnë përputhshmërinë me specifikimet e Dosjes së Tenderit. Në dokumentacionin teknik të ADETEX SH.P.K. është identifikuar modeli Thermocold DOMINO PROJECT PRO SEA 060 L, i paraqitur për kapacitetin rreth 100 kW. Mirëpo, nuk është identifikuar ë modeli konkret i ofruar për pozicionin me kapacitet ftohës 65 kW dhe kapacitet ngrohës 71 kW. Gjithashtu, nuk është gjetur fletë teknike zyrtare e prodhuesit që paraqet dhe nënvizon karakteristikat e modelit konkret për këtë kapacitet. Kjo mangësi është materiale dhe lidhet drejtpërdrejt me identifikimin e produktit të ofruar. Ajo nuk mund të plotësohet përmes sqarimit duke paraqitur pas afatit një model ose fletë teknike të re, sepse kjo do të mundësonte identifikimin ose ndryshimin e produktit pas afatit për dorëzimin e tenderëve. Prandaj, ADETEX SH.P.K. nuk e ka dëshmuar përmbushjen e Kërkesës 5 për pajisjen me kapacitet 65/71 kW.

2. Katalogu dhe dokumentet e prodhuesit te modifikuara Nga ekzaminimi i dokumentit

"Katalogu dhe deklarata e prodhuesit", të dorëzuar nga ADETEX SH.P.K., rezulton se dokumenti i paraqitur si katalog teknik nuk është katalogu origjinal dhe standard i publikuar nga prodhuesi Thermocold. Dokumenti është përgatitur dhe modifikuar manualisht për nevojat e ofertës së ADETEX SH.P.K.



SPECIFICATIONS

Thermocold THE AIRVOLUTION

Model name		DOMINO PROJECT PRO
Power supply	V/Ph/Hz	3V-/380-415V/50
Heating (LWT55°C/ OAT 7°C) Capacity	kW	100
Heating - Rated input	kW	28.4
Heating - COP	W/W	3.52
SCOP (55) average	W/W	3.85
SCOP (35) average	W/W	4.85
Cooling (LWT7°C/ OAT35°C) - Capacity	kW	100
Cooling - Rated input	kW	28.58
Cooling – EER	W/W	3.50
SEER	W/W	4.90
Air side heat exchanger - Type	/	Cooper Type&Aluminium Fin
Fan – Type	/	Axial
Fan – Motor Type	/	DC Motor

Rrjedhimisht, dokumentacioni i dorëzuar nga ADETEX SH.P.K. nuk e përmbush Dëshminë 5, sepse në vend të katalogut ose fletës teknike zyrtare të prodhuesit është dorëzuar një dokument i përgatitur dhe modifikuar manualisht për nevojat e ofertës.

3. Mungojnë katalogët për pajisjet përcjellëse (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) Kërkesa 5 nuk është kufizuar vetëm te pompa termike, por ka kërkuar shprehimisht katalogun ose fletën teknike zyrtare të prodhuesit edhe për pajisjet përcjellëse të ofruara. Dokumentacioni teknik i dorëzuar nga ADETEX SH.P.K. nuk përmban katalogë ose fletë teknike zyrtare të prodhuesve për të gjitha pajisjet përcjellëse të përfshira në ofertë, përfshirë, sipas pozicioneve relevante të paramasës: pompat qarkulluese; akumulatorët e nxehtësisë; enët ekspanduese; valvulat dhe pajisjet e tjera të kontrollit; pajisjet e tjera përcjellëse për të cilat kërkohet identifikimi i prodhuesit, markës, modelit dhe karakteristikave teknike. Pa këto dokumente nuk mund të verifikohet nëse pajisjet përcjellëse të ofruara përmbushin specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit. Dorëzimi pas afatit i katalogëve ose fletëve teknike që nuk kanë qenë pjesë e tenderit fillestar nuk do të përbënte vetëm sqarim të dokumenteve ekzistuese, por plotësim material të tenderit me dëshmi të reja. Prandaj, ADETEX SH.P.K. nuk e ka përmbushur Kërkesën 5 dhe Dëshminë 5 lidhur me pajisjet përcjellëse të ofruara.

5. Vendimi i AK-së nuk i trajton të gjitha pretendimet ankimore Kërkesa për rishqyrtim, e dorëzuar më 29.09.2026, përmbante pretendime të ndara dhe konkrete, të mbështetura në dokumentacionin e ofertave. Megjithatë, në vendimin e datës 02.10.2026, Autoriteti Kontraktues nuk është përgjigjur dhe nuk ka vendosur fare pretendimet kryesore, të cilat do shpienin në eliminim direkt të OE-ve. Në veçanti, AK-ja nuk i ka trajtuar pretendimet që kanë të bëjnë me: mungesën e katalogëve ose fletëve teknike zyrtare për pajisjet përcjellëse; mungesën e përkthimit në gjuhën shqipe të pjesëve relevante të katalogëve; mosshënimin ose mosnënvizimin e qartë të karakteristikave teknike të kërkuara; mosidentifikimin dhe mosdëshmimin e modelit konkret të ofertuar; mospërputhjen e modeleve të ofruara me kufijtë e detyrueshëm të

temperaturës; paraqitjen e disa modeleve të nënvizuara, duke ofruar variante; mungesën e dëshmive për marrëdhëniet dhe autorizimet ndërmjet prodhuesit, distributorit dhe operatorëve ekonomikë; mungesën e kontratave ose parakontratave të kërkuara për stafin e propozuar. Mosadresimi i këtyre pretendimeve nuk përbën refuzim të arsyetuar, por mungesë të shqyrtimit të tyre. AK-ja nuk mund të konsiderohet se e ka shqyrtuar kërkesën në tërësi vetëm duke dhënë një përgjigje të përgjithshme ose duke trajtuar disa prej pretendimeve, ndërsa pretendimet e tjera i ka lënë pa asnjë vlerësim dhe pa asnjë përfundim dhe kjo me vetëdije të plotë. Poashtu, vetë AK për disa pretendime e pranon se "duhet të verifikohen", çka tregon se vlerësimi nuk ishte përfunduar para shpalljes së fituesit. Për këtë arsye, vendimi i kundërshtuar nuk e përmbush detyrimin për shqyrtimin e plotë dhe arsyetimin e kërkesës për rishqyrtim, në pajtim me nenin 108/A, paragrafët 6, 9 dhe 12 të LPP-së, si dhe me nenet 61.3 dhe 62.2 të Rregullores për Prokurimin Publik. 1. Kërkesa drejtuar OSHP-së 1. Të aprovohet si e bazuar ankesa e EJONA SH.P.K. 2. Të anulohet vendimi i AK-së i datës 02.10.2026 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dhe Njoftimi B58 i datës 24.09.2026. 3. Aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim dhe AK të obligohet ti trajtojë të gjitha pretendimet dhe provat në mënyrë të plotë, të barabartë dhe të arsyetuar. 4. Të verifikohen nga eksperti shqyrtues dhe, sipas nevojës, nga ekspert i fushës termoteknike: modelet e ofruara, kufijtë e temperaturës, kapacitetet, katalogët e pajisjeve përcjellëse, përkthimet, autorizimet distributor-prodhues dhe dokumentacioni i stafit. 5. Të mos lejohet plotësimi pas afatit i ndonjë elementi material të ofertave dhe të shpallen të papërgjegjshme ofertat që nuk i përmbushin kërkesat detyruese të DT-së. 6. Pas rivlerësimit, kontrata ti jepet tenderuesit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët; duke qenë se oferta e EJONA SH.P.K. është konsideruar e përgjegjshme, ajo të trajtohet sipas renditjes që rezulton pas rivlerësimit ligjor.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: **1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rks-gov.net**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.**
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: **Kërkesa 1. Certifikata e Regjistrimit te Biznesit (ARBK) Kërkesa 2. Regjistrimi i TVSH –së**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1 Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (ARBK) -kopje Evidenca 2 Certifikata e TVSH-së kopje**
Kërkesa 3 Operatori Ekonomik duhet te kete certifikatat lidhur me kerkesat teknike; ISO standard -ISO 9001 2015 - Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë – ISO 14001 2015 – Sistemi i Menaxhimin Mjedisor – ISO 45001 2018 – Sistemi i menaxhimit të shëndetit	**Dëshmia 3 Certifikatat ISO valide per te njejten natyre si projekti (kopje) Vrejtje Çertifikatat e natyres se njejt ISO më të avansuara pranohen**

dhe sigurise ne pune	
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1 Për Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik,gjat tre vite të fundit financiare duhet te jet jo më pak se 520.000.00 Euro. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar të qarkullimit vjetor për 3 vitet e fundit.	**Dëshmia 1 Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo ne vendin e themelimit apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menagjimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur**
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjajeshme në vlerë prej 390.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3 vitet e shkuara.	**Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat për kryerje të punëve.**
Kërkesa 2 Menaxheri i projektit të jetë Inxhinier i Makineris drejtimi Termoenergjetikes, me së paku 5 (pesë) vite përvojë pune pas diplomimit i licensuar Kategoria A Të jetë i certifikuar me certifikaten e Auditimit e energjise ne ndertesa	**Dëshmia 2 Për menaxher të projektit CV, diploma, kontrata e punës apo parakontrata për projektin në fjalë. Certifikata e auditimit te energjis ne ndertsa dhe licencen e Kategoris A**
Kërkesa 3 Një (1) inxhinier i diplomuar i Termoteknikes , me minimum 3 vite përvojë pune.	**Dëshmia 3 Për inxhinierin e Termoteknikes CV, diploma, kontrata e punës apo parakontrata për projektin në fjalë.**
Kërkesa 4 Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesionale. - Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt -minimumi 10 punonjës.	**Dëshmia 4 Lista e punëtoreve me kontrata apo para kontrata ne emer te projektin ne prani te dy paleve minimum 10 punëtorë**
Kërkesa 5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalogun ose fletën teknike të prodhuesit për pompën termike dhe pajisjet përcjellëse të ofruara, me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Katalogu fleta teknike duhet të përmbajë së paku emrin e prodhuesit, markën, modelin, kapacitetin, karakteristikat teknike, efikasitetin energjetik dhe të dhënat e tjera relevante të pajisjes së ofruar.	**Dëshmia 5 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë Katalogun, prospektin ose fletën teknike zyrtare të prodhuesit për pompën termike dhe pajisjet përcjellëse të ofruara; Dokumenti duhet të identifikojë qartë prodhuesin, markën dhe modelin e pajisjes; Në katalog fletën teknike duhet të shënohen ose të nënvizohen qartë karakteristikat teknike që dëshmojnë përputhshmërinë me specifikimet e Dosjes së Tenderit; Dokumenti mund të paraqitet në gjuhën shqipe ose në gjuhën origjinale, i shoqëruar me përkthim në gjuhën shqipe për pjesët relevante.**
Kërkesa 6 Autorizimi nga prodhuesi Operatori Ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi i pompës termike të ofruar ose nga përfaqësuesi distributori i autorizuar i prodhuesit, për ofertimin, furnizimin, montimin dhe ofrimin e garancisë dhe servisit për pajisjen	**Dëshmia 6 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë ,Autorizim të vlefshëm nga prodhuesi i pompës termike; ose Autorizim nga përfaqësuesi distributori i autorizuar, i shoqëruar me dëshmi që vërteton lidhjen e tij me prodhuesin. Autorizimi duhet,Të jetë**

përkatëse.	**lëshuar në emër të Operatorit Ekonomik ofertues;Të identifikojë prodhuesin, markën dhe, sipas mundësisë, modelin e pajisjes së ofruar; T'i referohet aktivitetit të prokurimit "Blerja dhe montimi i pompës termike për administratë", duke përfshirë numrin e prokurimit**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	Blerja dhe montimi i pompës termike për administratë		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	" CTA " Sh.p.k., 600028816	30000	Pjeter Bogdani Nr 24

DEKLARATË

[të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim]

CTA " Sh.p.k..është në përputhje me te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe ne ketë rast sipas kriterit për dhënie te kontratës (Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet) shpallet fitues nga komisioni i vlerësimit, sepse ka ofruar çmimin me te lire Oferta e këtij është € 183,156.00

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E PROKURIMIT
KOMUNA E PEJËS

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: : Blerja dhe montimi i pompës termike për administratë

Nr. i prokurimit [1]	635-26-7196-5-2-1
Nr i brendshëm	635-26-067-521

Radhë	Lënda / grupi: Blerja dhe montimi i pompës termike për administratë	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	**" CTA " Sh.p.k., 600028816**	**183,156.00**
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik EKOTERMIKA SH.P.K.; HARST Group SH.P.K.,	224,224.00
3.	2B ENGINEERING SH.P.K., 812213693	232,239.00
4.	Adetex SH.P.K., 600407739	238,994.93
5.	" EJONA " SH.P.K., 810089913	242,242.00

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

KOMUNA E PEJES **shpërblen** me kontratë **" CTA " Sh.p.k.,** ne vlere totale te ofertës: **183,156.00**

Data: **24.09.2026**

Menaxher i Prokurimit
Milot Gashi

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Operatori Ekonomik Ankues “"OE “" EJONA " SH.P.K.”- Prishtinë është palë me interes sipas nenit: 4.1.26 në këtë aktivitet të prokurimit

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" EJONA " SH.P.K.**

CTA SH.P.K. – OE i rekomanduar për Kontratë.

Pretendimi I. Mungojnë katalogët për pajisjet përcjellëse (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) CTA ka dorëzuar katalog për pompat termike Haier, por nuk janë gjetur katalogë ose fletë teknike zyrtare për pajisjet përcjellëse të ofertës, si pompat qarkulluese, akumulatorët, enët ekspanduese dhe pajisjet e tjera relevante. Kërkesa 5 nuk kufizohet vetëm te pompa termike, por kërkon katalog edhe për pajisjet përcjellëse. sipas pozicioneve relevante të paramasës: pompat qarkulluese; akumulatorët e nxehtësisë; enët ekspanduese; valvulat dhe pajisjet e tjera të kontrollit; pajisjet e tjera përcjellëse për të cilat kërkohet identifikimi i prodhuesit, markës, modelit dhe karakteristikave teknike.

Kërkesa 5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalogun ose fletën teknike të prodhuesit për pompën termike dhe pajisjet përcjellëse të ofruara, me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Katalogu fleta teknike duhet të përmbajë së paku emrin e prodhuesit, markën, modelin, kapacitetin, karakteristikat teknike, efikasitetin energjetik dhe të dhënat e tjera relevante të pajisjes së ofruar.	Dëshmia 5 Operatori Ek dorëzojë Katalogun, prosp teknike zyrtare të prodhues termike dhe pajisjet përcjel Dokumenti duhet të identifi prodhuesin, markën dhe m katalog fletën teknike duhe nënvizohen qartë karakteris dëshmojnë përputhshmërin Dosjes së Tenderit; Dokum paraqitet në gjuhën shqipe origjinale, i shoqëruar me p shqipe për pjesët relevante.

Përgjigjeje në pretendimin I,

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP), i ndryshuar dhe plotësuar, Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në versionin e konsoliduar me ndryshimet që kanë hyrë në fuqi më 11.11.2024, Dosjes së Tenderit të datës 26.08.2026, kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) më 29.09.2026, vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) të datës 02.10.2026, si dhe pas shqyrtimit të ofertave të dorëzuara në platformën elektronike E-Prokurimi dhe dokumentacionit tjetër relevant të lëndës, eksperti shqyrtues paraqet vlerësimin në vijim.

Vlerësimi mbështetet, ndër të tjera, në nenin59 dhe nenin 72 të LPP-së, si dhe në nenet 38 dhe 40 të Rregullores, në masën që këto dispozita janë të zbatueshme për çështjen konkrete.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka përcaktuar kërkesën që Operatori Ekonomik të paraqesë katalogun, prospektin ose fletën teknike zyrtare të prodhuesit për pompën termike dhe pajisjet përcjellëse të ofruara.

Sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, dokumentacioni teknik është kërkuar me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë së pajisjeve të propozuara me specifikimet teknike të përcaktuara nga AK. Dokumentacioni përkatës është dashur të përmbajë, së paku, emrin e prodhuesit, markën, modelin, kapacitetin, karakteristikat teknike, efikasitetin energjetik dhe të dhënat e tjera relevante të pajisjes së ofruar, sipas natyrës së pajisjes dhe kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Nga krahasimi i kërkesave të Dosjes së Tenderit me dokumentacionin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, konstatohet se ky operator ka paraqitur katalogun për pompën termike, por nuk rezulton të ketë dorëzuar katalogun, prospektin ose fletën teknike zyrtare të prodhuesit për pajisjet përcjellëse të kërkuara në Dosjen e Tenderit.

Rrjedhimisht, dokumentacioni i paraqitur nuk mundëson verifikimin e plotë dokumentar të

karakteristikave teknike dhe të përputhshmërisë së pajisjeve përcjellëse me kërkesat e përcaktuara nga AK.

Eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa për paraqitjen e katalogut ose fletës teknike të prodhuesit për pompën termike dhe pajisjet përcjellëse përbën një kërkesë të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, e cila duhet të shqyrtohet dhe të zbatohet në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë operatorëve ekonomik.

Në këtë drejtim,neni 40, paragrafi 40.2, i Rregullores Nr. 001/2022, versioni konsoliduar 11.11.2024 përcakton se ofertat duhet të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk mund të ndryshojë, modifikojë ose të heqë kërkesat e përcaktuara paraprakisht gjatë procesit të vlerësimit.

Duke u mbështetur në gjendjen faktike të përshkruar dhe në dispozitat e lartcekura, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor lidhur me mungesën e katalogut ose fletës teknike zyrtare për pajisjet përcjellëse është i bazuar në aspektin e konstatimit të mungesës së dokumentacionit të kërkuar.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues para publikimit njoftimit mbi vendimin B58, bazuar në nenin nenit 72 të LPP-së, ka mundur të kërkoj sqarimet e nevojshme, dhe të bëje verifikimin e së njejtes, rrjedhimisht pretendimi **është i bazuar**.

Pretendimi II. Katalogu nuk është përkthyer në shqip (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) Katalogu Haier është në gjuhën angleze dhe nuk është shoqëruar me përkthimin në shqip të pjesëve relevante, siç kërkohet shprehimisht nga Dëshmia 5.

Përgjigjeje në pretendimin II.

Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe Dosjes së Tenderit, përkatësisht kërkesës së përcaktuar në Dëshminë 5, eksperti vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht se katalogu, prospekti ose fleta teknike mund të dorëzohet në gjuhën shqipe ose në gjuhën origjinale, me kusht që dokumenti në gjuhën origjinale të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të pjesëve relevante. Meqenëse katalogu i prodhuesit Haier është dorëzuar në gjuhën angleze dhe nuk është shoqëruar me përkthimin përkatës, eksperti vlerëson se Autoriteti Kontraktues, në mbështetje të nenit 72 të LPP-së dhe dispozitave përkatëse të Rregullores dhe Udhëzuesit për Prokurimin Publik, ka mundur të shqyrtoj mundësinë e kërkimit të sqarimeve nga Operatori Ekonomik, me qëllim të verifikimit të përmbushjes së kërkesave të Dosjes së Tenderit. Sqarimet duhet të kufizohen në dokumentacionin e dorëzuar dhe nuk duhet të mundësojnë ndryshimin e ofertës apo plotësimin e elementeve thelbësore të saj pas afatit të dorëzimit. Autoriteti Kontraktues duhet të vlerësojë nëse përmes sqarimeve mund të konfirmohet përputhshmëria me kërkesat e përcaktuara në Dëshminë 5, duke respektuar parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, rrjedhimisht pretendimi **është i bazuar!**

Pretendimi III. Karakteristikat relevante nuk janë shënuar/nënvizuar qartë, Në katalog nuk

janë identifikuar në mënyrë të qartë të gjitha karakteristikat që dëshmojnë përputhjen me specifikimet e AK-së.

Përgjigjeje në pretendimin III.

Pas shqyrtimit të pretendimit dhe katalogut teknik të dorëzuar nga operatori ekonomik, eksperti konstaton se katalogu përmban tabelën e specifikimeve teknike të pajisjeve, ku janë paraqitur në mënyrë të strukturuar karakteristikat relevante, përfshirë kapacitetin, fuqinë hyrëse, efikasitetin, performancën në ngrohje dhe ftohje, diapazonin e temperaturave të punës, llojin e kompresorit, ftohësin, prurjen e ujit dhe dimensionet e pajisjeve. Të dhënat janë të paraqitura veçmas për modelet përkatëse, duke mundësuar krahasimin dhe verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Vlerësohet se katallogu përmbane karakteristikat në vetvete, gjithashtu nuk është gjetur se ka mospërputhjen e produktit me kërkesat teknike, përderisa të dhënat përkatëse janë të përfshira në dokumentacionin e dorëzuar dhe mund të verifikohen përmes krahasimit me kërkesat e Dosjes së Tenderit

Rrjedhimisht, duke marrë parasysh DT, përmbajtjen e katalogut dhe faktin se karakteristikat teknike të paraqitura mundësojnë verifikimin e specifikimeve të kërkuara, eksperti vlerëson se pretendimi në këtë pikë **është i pabazuar.**

Pretendimi IV. Mungon dëshmia e lidhjes ndërmjet Haier-it dhe EngOffice (për këtë pretendim AK ka thënë se duhet të verifikohet) Autorizimi është lëshuar nga EngOffice. Nuk është dorëzuar dokumenti nga prodhuesi Haier që dëshmon se EngOffice është distributor ose përfaqësues i autorizuar i prodhuesit. Kjo nuk e përmbush plotësisht Dëshminë 6, e cila kërkon edhe dëshminë e marrëdhënies distributor–prodhues.

Kërkesa 6 Autorizimi nga prodhuesi Operatori Ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi i pompës termike të ofruar ose nga përfaqësuesi distributori i autorizuar i prodhuesit, për ofertimin, furnizimin, montimin dhe ofrimin e garancisë dhe servisit për pajisjen përkatëse.	**Dëshmia 6 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë ,Autorizim të vlefshëm nga prodhue i pompës termike; ose Autorizim nga përfaqësuesi distributori i autorizuar, i shoqëruar me dëshmi që vërteton lidhjen e tij me prodhuesin. Autorizimi duhet,Të jetë lëshuar në emër të Operatorit Ekonomik ofertues;Të identifikojë prodhuesin, markën dhe, sipas mundësisë, modelin e pajisjes së ofruar; T'i referohet aktivitetit të prokurimit "Blerja dhe montimi i pompës termike për administratë", duke përfshirë numrin e prokurimit**

Përgjigjeje në pretendimin IV.


Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, Dosjes së Tenderit, përkatësisht Kërkesës 6 dhe

Dëshmisë 6, si dhe vendimit të Autoritetit Kontraktues për kërkesën për rishqyrtim, eksperti vlerëson se dokumentet e tenderit kanë përcaktuar shprehimisht se, në rastet kur autorizimi lëshohet nga përfaqësuesi ose distributori i autorizuar, ai duhet të shoqërohet me dëshmi që vërteton lidhjen e tij me prodhuesin. Në rastin konkret, autorizimi është lëshuar nga EngOffice, ndërsa ankuesi pretendon se nuk është dorëzuar dëshmi që vërteton marrëdhënien e autorizuar ndërmjet EngOffice dhe prodhuesit Haier.

Për rrjedhojë, eksperti vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim te bejë këtë verifikim dokumentit para publikimit të njoftimit mbi vendimin B58, nëse EngOffice ka pasur marrëdhënie të autorizuar me prodhuesin Haier para skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave, pa lejuar ndryshimin material të ofertës. Nëse kjo marrëdhënie nuk dëshmohet dhe nuk mund të vërtetohet në mënyrën e lejuar, atëherë duhet të vlerësohet nëse oferta i përmbush kërkesat e Dëshmisë 6 dhe dispozitat përkatëse të LPP-së.

Ky pretendimi ankimor vlerësohet **si i bazuar**, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka dëshmuar se ka verifikuar përmbushjen e kërkesës së përcaktuar në Dëshminë 6, përkatësisht ekzistencën e dëshmisë që vërteton lidhjen ndërmjet EngOffice dhe prodhuesit Haier.

Pretendimi V. Inxhinieri nuk ploteson kriterin 3 vite pervoje pune CTA SH.P.K. për Kërkesa 3 : "inxhinier i diplomuar i Termoteknikës, me minimum 3 vite përvojë pune". ka dorëzuar dokumentet e inxhinierit Ilir Elezaj i cili nuk posedon së paku tri vite përvojë profesionale relevante pas fitimit të kualifikimit përkatës (Inxhinier i makinerisë). Diploma e dorëzuar dëshmon se Ilir Elezaj i ka përfunduar studimet në programin Termoenergjetikë dhe Termoteknikë më 4 dhjetor 2025. Deri në afatin për dorëzimin e tenderëve, më 15 shtator 2026, nga diplomimi kishin kaluar vetëm rreth nëntë muaj.



FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE NË PRISHTINË

FACULTY OF MECHANICAL ENGINEERING IN PRISHTINA

Diplomë Diploma

ILIR SHAQIR ELEZAJ

U lind më 19.08.1994 në Pejë.	Born on 19.08.1994 in Pejë.
U regjistrua në vitin akademik 2023/2024 në studimet master.	Was enrolled in the academic year 2023/2024 in master studies.
Studimet i mbaroi më 4 dhjetor 2025.	Completed his/her studies on 4 December 2025.
Gjithsej 120 pikë - ECTS	Total ECTS 120
Nota mesatare gjatë studimeve 7,75	Average grade of studies 7,75
E mbrojti me sukses temën e masterit:	Defended his/her Master Thesis:
Projektimi i sistemit të gazrave medicinal për spitalin e Ferizajt	Design of medical gases hospital of Ferizaj

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar angazhimin e një inxhinieri të diplomuar –(e jo Bachelor të inxhinierisë), me së paku tri (3) vite përvojë profesionale. Meqenëse titulli dhe kualifikimi i kërkuar shprehimisht është Inxhinier i Makinerisë, përvoja relevante për përmbushjen e këtij kriteri duhet të llogaritet nga data kur personi e ka fituar këtë titull akademik. Titulli Inxhinier i Makinerisë fitohet pas përfundimit të studimeve Master sipas sistemit te Bolonjes, ose sipas sistemit të vjetër që nuk kishin nevojë ta kryenin veçmas Masterin për ta fituar titullin "inxhinier i diplomuar". Ndërsa me logjikën e AK se përvoja njifet edhe para përfitimit të titullit inxhinier, kështu do mund të vlente edhe përvoja e mëparshme kur individi nuk ka qenë as në fakultet dhe pa asnjë aftësi profesionale.

Përgjigjeje në pretendimin V.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumenteve të paraqitura në ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, përkatësisht CV-së, diplomës dhe dokumenteve të tjera relevante për inxhinierin e propozuar të termoteknikës, eksperti konstaton se nga të dhënat e pasqyruara në CV rezulton se inxhinieri ka më shumë se tri (3) vite përvojë profesionale pas përfundimit të studimeve bachelor. Fakti që kjo përvojë nuk është fituar pas përfundimit të studimeve master nuk përbën në vetvete mospërmbushje të kriterit, pasi Dosja e Tenderit nuk përcakton një kusht të tillë. Rrjedhimisht, duke u bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, eksperti vlerëson se kriteri për përvojën profesionale prej së paku tri (3) vitesh është përmbushur.

Në këtë drejtim, në mbështetje të neneve 7, 51 dhe 59 lidhur me nenin 69 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar, kërkohet që përmbushja e kriterit të vlerësohet në bazë të kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe dëshmive të paraqitura, duke dalluar nivelin e kualifikimit arsimor nga kohëzgjatja e përvojës profesionale, andaj pretendimi në këtë pikë **vlerësohet si i pabazuar.**

Grupi i OE EKOTERMIKA SH.P.K. & HARST Group SH.P.K.

Pretendimi I. Mungojnë katalogët për pajisjet përcjellëse (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) Dokumentacioni teknik përmban katalogun Haier për chiller-at, por nuk janë gjetur katalogë ose fletë teknike zyrtare për pajisjet përcjellëse të ofertës, si pompat qarkulluese, akumulatorët, enët ekspanduese dhe pajisjet e tjera relevante. Kërkesa 5 nuk kufizohet vetëm te pompa termike, por kërkon katalog edhe për pajisjet përcjellëse sipas pozicioneve relevante të paramasës: pompat qarkulluese; akumulatorët e nxehtësisë; enët ekspanduese; valvulat dhe pajisjet e tjera të kontrollit; pajisjet e tjera përcjellëse për të cilat kërkohet identifikimi i prodhuesit, markës, modelit dhe karakteristikave teknike.

Përgjigjeje në pretendimin I.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP), i ndryshuar dhe plotësuar, Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në versionin e konsoliduar me ndryshimet që kanë hyrë në fuqi më 11.11.2024, Dosjes së Tenderit të datës 26.08.2026, kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) më 29.09.2026, vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) të datës 02.10.2026, si dhe pas shqyrtimit të ofertave të dorëzuara në platformën elektronike E-Prokurimi dhe dokumentacionit tjetër relevant të lëndës, eksperti shqyrtues paraqet vlerësimin në vijim.

Vlerësimi mbështetet, ndër të tjera, në nenin59 dhe nenin 72 të LPP-së, si dhe në nenet 38 dhe 40 të Rregullores, në masën që këto dispozita janë të zbatueshme për çështjen konkrete.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka përcaktuar kërkesën që Operatori Ekonomik të paraqesë katalogun, prospektin ose

fletën teknike zyrtare të prodhuesit për pompën termike dhe pajisjet përcjellëse të ofruara.

Sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, dokumentacioni teknik është kërkuar me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë së pajisjeve të propozuara me specifikimet teknike të përcaktuara nga AK. Dokumentacioni përkatës është dashur të përmbajë, së paku, emrin e prodhuesit, markën, modelin, kapacitetin, karakteristikat teknike, efikasitetin energjetik dhe të dhënat e tjera relevante të pajisjes së ofruar, sipas natyrës së pajisjes dhe kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Nga krahasimi i kërkesave të Dosjes së Tenderit me dokumentacionin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, konstatohet se ky operator ka paraqitur katalogun për pompën termike, por nuk rezulton të ketë dorëzuar katalogun, prospektin ose fletën teknike zyrtare të prodhuesit për pajisjet përcjellëse të kërkuara në Dosjen e Tenderit.

Rrjedhimisht, dokumentacioni i paraqitur nuk mundëson verifikimin e plotë dokumentar të karakteristikave teknike dhe të përputhshmërisë së pajisjeve përcjellëse me kërkesat e përcaktuara nga AK.

Eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa për paraqitjen e katalogut ose fletës teknike të prodhuesit për pompën termike dhe pajisjet përcjellëse përbën një kërkesë të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, e cila duhet të shqyrtohet dhe të zbatohet në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë operatorëve ekonomik.

Në këtë drejtim,neni 40, paragrafi 40.2, i Rregullores Nr. 001/2022, versioni konsoliduar 11.11.2024 përcakton se ofertat duhet të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk mund të ndryshojë, modifikojë ose të heqë kërkesat e përcaktuara paraprakisht gjatë procesit të vlerësimit.

Duke u mbështetur në gjendjen faktike të përshkruar dhe në dispozitat e lartcekura, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor lidhur me mungesën e katalogut ose fletës teknike zyrtare për pajisjet përcjellëse është i bazuar në aspektin e konstatimit të mungesës së dokumentacionit të kërkuar.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues para publikimit njoftimit mbi vendimin B58, bazuar në nenin nenit 72 të LPP-së, ka mundur të kërkoj sqarimet e nevojshme, dhe të bëje verifikimin e së njejtes, rrjedhimisht pretendimi **është i bazuar**.

Pretendimi II. Katalogu është vetëm në anglisht (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) Pjesët relevante të katalogut Haier nuk janë shoqëruar me përkthim në shqip.

Përgjigjeje në pretendimin II.

Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe Dosjes së Tenderit, përkatësisht kërkesës së përcaktuar në Dëshminë 5, eksperti vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht se katalogu, prospekti ose fleta teknike mund të dorëzohet në gjuhën shqipe ose në gjuhën origjinale, me kusht që dokumenti në gjuhën origjinale të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të pjesëve relevante. Meqenëse katalogu i prodhuesit Haier është dorëzuar në gjuhën angleze dhe nuk është shoqëruar me përkthimin përkatës, eksperti vlerëson se Autoriteti Kontraktues, në mbështetje të nenit 72 të LPP-së dhe dispozitave përkatëse të Rregullores dhe Udhëzuesit për Prokurimin Publik, ka mundur të shqyrtoj mundësinë e kërkimit të sqarimeve nga Operatori Ekonomik, me qëllim të verifikimit të përmbushjes së kërkesave të Dosjes së Tenderit. Sqarimet duhet të kufizohen në dokumentacionin e dorëzuar dhe nuk duhet të mundësojnë ndryshimin e ofertës apo plotësimin e elementeve thelbësore të saj pas afatit të dorëzimit. Autoriteti Kontraktues duhet të vlerësojë nëse përmes sqarimeve mund të konfirmohet përputhshmëria me kërkesat e përcaktuara në Dëshminë 5, duke respektuar parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, rrjedhimisht pretendimi **është i bazuar!**

Pretendimi III. Paqartësi rreth modelit të ofertuar - VARIANT Në katalog dhe autorizim paraqiten disa modele, përfshirë: CA0070HANH; CA0100HANH; CA0140HANH; modele të tjera të serisë EAND. OE në katalog ka nënvizuar edhe modelin CA0140HANH duke tentuar kështu të ofrojë variante për AK dhe duke krijuar pasiguri në produktet e ofertuara. Gjë që e bën automatikisht ofertën variant, dhe variantet janë të papranueshme nga AK në këtë DT.



Përgjigjeje në pretendimin III.

Pas shqyrtimit dhe krahasimit të pretendimit ankimor, Kërkesës 5 të Dosjes së Tenderit, katalogut teknik të prodhuesit dhe autorizimit të distributorit ekskluziv, eksperti vlerëson se pretendimi ankimor është **i pabazuar**. Kjo për faktin se Kërkesa 5 e Dosjes së Tenderit kërkon paraqitjen e katalogut ose fletës teknike të prodhuesit për pajisjen e ofruar, me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë me specifikimet teknike të Autoritetit Kontraktues, duke përfshirë modelin, kapacitetin dhe karakteristikat relevante. Në rastin konkret, katalogu teknik paraqet modelet përkatëse dhe karakteristikat teknike të secilit model, ndërsa autorizimi(vertetimi i cili duhet te behet gjate Rivleresimit) i distributorit konfirmon të drejtën e operatorit ekonomik për furnizimin me pajisjet e listuara. Fakti që në këto dokumente përmenden disa modele të së njëjtës seri, si dhe nënvizimi i njërit prej tyre në katalog, nuk dëshmon vetvetiu se operatori ekonomik ka paraqitur variante të ndryshme në ofertën e tij.


Pretendimi IV. Mungon dëshmia e marrëdhënies Haier–EngOffice Autorizimi është lëshuar nga EngOffice, por nuk është gjetur dokument zyrtar nga Haier që dëshmon statusin e EngOffice si distributor/përfaqësues i autorizuar.

P**ërgjigjeje në pretendimin IV.**

Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe Dosjes së Tenderit, përkatësisht kërkesës së përcaktuar në Dëshminë 5, eksperti vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht se katalogu, prospekti ose fleta teknike mund të dorëzohet në gjuhën shqipe ose në gjuhën origjinale, me kusht që dokumenti në gjuhën origjinale të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të pjesëve relevante. Meqenëse katalogu i prodhuesit Haier është dorëzuar në gjuhën angleze dhe nuk është shoqëruar me përkthimin përkatës, eksperti vlerëson se Autoriteti Kontraktues, në mbështetje të nenit 72 të LPP-së dhe dispozitave përkatëse të Rregullores dhe Udhëzuesit për Prokurimin Publik, ka mundur të shqyrtoj mundësinë e kërkimit të sqarimeve nga Operatori Ekonomik, me qëllim të verifikimit të përmbushjes së kërkesave të Dosjes së Tenderit. Sqarimet duhet të kufizohen në dokumentacionin e dorëzuar dhe nuk duhet të mundësojnë ndryshimin e ofertës apo plotësimin e elementeve thelbësore të saj pas afatit të dorëzimit. Autoriteti Kontraktues duhet të vlerësojë nëse përmes sqarimeve mund të konfirmohet përputhshmëria me kërkesat e përcaktuara në Dëshminë 5, duke respektuar parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, rrjedhimisht pretendimi **është i bazuar!**

2B ENGINEERING SH.P.K.

Pretendimi I. Pretendimet ne vazhdim : mospërputhje teknike e produktit Midea (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) 2B ka nënvizuar modelet: MH-SU75-RN8L; ? MH-SU110-RN8L. Katalogu zyrtar përcakton: Karakteristika Kërkesa e AK-së Katalogu Midea Funksionimi në ftohje –20°C deri +53°C –15°C deri +48°C Funksionimi në ngrohje –25°C deri +50°C –25°C deri +43°C Pra, pajisja Midea: nuk punon deri në –20°C në ftohje; nuk punon deri në +53°C në ftohje; nuk punon deri në +50°C në ngrohje.



Kjo është mospërputhje materiale që del drejtpërdrejt nga katalogu i vetë OE-së. Pra, produktet e ofertuara nuk plotësojnë kërkesat minimale të specifikimit teknik.

Përgjigjeje në pretendimin I.

Pas shqyrtimit dhe krahasimit të dokumentacionit relevant, përkatësisht katalogut të dorëzuar nga OE me specifikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, eksperti shqyrtues vlerëson se katalogu nuk dëshmon përmbushjen e kërkesave teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Rrjedhimisht, duke qenë se dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon përputhshmërinë e produktit të ofertuar me kërkesat e Dosjes së Tenderit, eksperti vlerëson se pretendimi ankimor **është i bazuar.**

Pretendimi II. Mungon përkthimi në shqip (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) Katalogu është në anglisht dhe nuk përmban përkthimin në shqip të pjesëve relevante. Poashtu edhe per katalogjet e kerkuara tek kerkesa 5 ku kerkohen katalogjet teknike per te gjithe pozicionet percjellese, OE ka prezentuar vetem disa prej tyre dhe jo komplet.

Përgjigjeje në pretendimin II.


Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe Dosjes së Tenderit, përkatësisht kërkesës së përcaktuar në Dëshminë 5, eksperti vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht se katalogu, prospekti ose fleta teknike mund të dorëzohet në gjuhën shqipe ose në gjuhën origjinale, me kusht që dokumenti në gjuhën origjinale të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të pjesëve relevante. Meqenëse katalogu i prodhuesit është dorëzuar në gjuhën angleze dhe nuk është shoqëruar me përkthimin përkatës, eksperti vlerëson se Autoriteti Kontraktues, në mbështetje të nenit 72 të LPP-së dhe dispozitave përkatëse të Rregullores dhe Udhëzuesit për Prokurimin Publik, ka mundur të shqyrtoj mundësinë e kërkimit të sqarimeve nga Operatori Ekonomik, me qëllim të verifikimit të përmbushjes së kërkesave të Dosjes së Tenderit. Sqarimet duhet të kufizohen në dokumentacionin e dorëzuar dhe nuk duhet të mundësojnë ndryshimin e ofertës apo plotësimin e elementeve thelbësore të saj pas afatit të dorëzimit. Autoriteti Kontraktues duhet të vlerësojë nëse përmes sqarimeve mund të konfirmohet përputhshmëria me kërkesat e përcaktuara në Dëshminë 5, duke respektuar parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, rrjedhimisht pretendimi **është pjesërisht i bazuar!**

4. **ADETEX SH.P.K.** 1. Mungon modeli për kapacitetin 65/71 kW (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) Në paramasën e objektit të Kadastrës është kërkuar një pompë termike me kapacitet ftohës 65 kW dhe kapacitet ngrohës 71 kW. Sipas Kërkesës 5 dhe Dëshmisë 5, operatori ekonomik ka qenë i obliguar të dorëzojë katalogun, prospektin ose fletën teknike zyrtare të prodhuesit, në të cilën duhet të identifikohen qartë: prodhuesi;marka;modeli konkret i pajisjes së ofruar;kapaciteti ftohës dhe ngrohës;karakteristikat teknike;efikasiteti energjetik;karakteristikat që dëshmojnë përputhshmërinë me specifikimet e Dosjes së Tenderit. Në dokumentacionin teknik të ADETEX SH.P.K. është identifikuar modeli Thermocold DOMINO PROJECT PRO SEA 060 L, i paraqitur për kapacitetin rreth 100 kW. Mirëpo, nuk është identifikuar ë modeli konkret i ofruar për pozicionin me kapacitet ftohës 65 kW dhe kapacitet ngrohës 71 kW. Gjithashtu, nuk është gjetur fletë teknike zyrtare e prodhuesit që paraqet dhe nënvizon karakteristikat e modelit konkret për këtë kapacitet. Kjo mangësi është materiale dhe lidhet drejtpërdrejt me identifikimin e produktit të ofruar. Ajo nuk mund të plotësohet përmes sqarimit duke paraqitur pas afatit një model ose fletë teknike të re, sepse kjo do të mundësonte identifikimin ose ndryshimin e produktit pas afatit për dorëzimin e tenderëve. Prandaj, ADETEX SH.P.K. nuk e ka dëshmuar përmbushjen e Kërkesës 5 për pajisjen me kapacitet 65/71 kW.

Përgjigjeje në pretendimin I.

Pas shqyrtimit dhe krahasimit të dokumentacionit relevant, përkatësisht katalogut të dorëzuar nga OE me specifikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, eksperti shqyrtues vlerëson se katalogu nuk dëshmon përmbushjen e kërkesave teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Rrjedhimisht, duke qenë se dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon përputhshmërinë e produktit të ofertuar me kërkesat e Dosjes së Tenderit, eksperti vlerëson se pretendimi ankimor **është i bazuar.**

Pertendimi II. Katalogu dhe dokumentet e prodhuesit te modifikuara Nga ekzaminimi i dokumentit "Katalogu dhe deklarata e prodhuesit", të dorëzuar nga ADETEX SH.P.K., rezulton se dokumenti i paraqitur si katalog teknik nuk është katalogu origjinal dhe standard i publikuar nga prodhuesi Thermocold. Dokumenti është përgatitur dhe modifikuar manualisht për nevojat e ofertës së ADETEX SH.P.K.



SPECIFICATIONS

Thermocold THE AIRVOLUTION

Model name		DOMINO PROJECT PRO
Power supply	V/Ph/Hz	3V-/380-415V/50
Heating (LWT55°C/ OAT 7°C) Capacity	kW	100
Heating - Rated input	kW	28.4
Heating - COP	W/W	3.52
SCOP (55) average	W/W	3.85
SCOP (35) average	W/W	4.85
Cooling (LWT7°C/ OAT35°C) - Capacity	kW	100
Cooling - Rated input	kW	28.58
Cooling – EER	W/W	3.50
SEER	W/W	4.90
Air side heat exchanger - Type	/	Cooper Type&Aluminium Fin
Fan – Type	/	Axial
Fan – Motor Type	/	DC Motor

Rrjedhimisht, dokumentacioni i dorëzuar nga ADETEX SH.P.K. nuk e përmbush Dëshminë 5, sepse në vend të katalogut ose fletës teknike zyrtare të prodhuesit është dorëzuar një dokument i përgatitur dhe modifikuar manualisht për nevojat e ofertës.

Përgjigjeje në pretendimin II.

Pas shqyrtimit dhe krahasimit të dokumentacionit relevant, përkatësisht katalogut të dorëzuar nga OE me specifikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, eksperti shqyrtues vlerëson se katalogu nuk dëshmon përmbushjen e kërkesave teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Rrjedhimisht, duke qenë se dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon përputhshmërinë e produktit të ofertuar me kërkesat e Dosjes së Tenderit, eksperti vlerëson se pretendimi ankimor **është i bazuar.**

Pretendimi III. Mungojnë katalogët për pajisjet përcjellëse (për këtë pretendim AK nuk ka kthyer fare përgjigje) Kërkesa 5 nuk është kufizuar vetëm te pompa termike, por ka kërkuar shprehimisht katalogun ose fletën teknike zyrtare të prodhuesit edhe për pajisjet përcjellëse të ofruara. Dokumentacioni teknik i dorëzuar nga ADETEX SH.P.K. nuk përmban katalogë ose fletë teknike zyrtare të prodhuesve për të gjitha pajisjet përcjellëse të përfshira në ofertë, përfshirë, sipas pozicioneve relevante të paramasës: pompat qarkulluese; akumulatorët e nxehtësisë; enët ekspanduese; valvulat dhe pajisjet e tjera të kontrollit; pajisjet e tjera përcjellëse për të cilat kërkohet identifikimi i prodhuesit, markës, modelit dhe karakteristikave teknike. Pa këto dokumente nuk mund të verifikohet nëse pajisjet përcjellëse të ofruara përmbushin specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit. Dorëzimi pas afatit i katalogëve ose fletëve teknike që nuk kanë qenë pjesë e tenderit fillestar nuk do të përbënte vetëm sqarim të dokumenteve ekzistuese, por plotësim material të tenderit me dëshmi të reja. Prandaj, ADETEX SH.P.K. nuk e ka përmbushur Kërkesën 5 dhe Dëshminë 5 lidhur me pajisjet përcjellëse të ofruara.

Përgjigjeje në pretendimin III.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP), i ndryshuar dhe plotësuar, Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në versionin e konsoliduar me ndryshimet që kanë hyrë në fuqi më 11.11.2024, Dosjes së Tenderit të datës 26.08.2026, kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) më 29.09.2026, vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) të datës 02.10.2026, si dhe pas shqyrtimit të ofertave të dorëzuara në platformën elektronike E-Prokurimi dhe dokumentacionit tjetër relevant të lëndës, eksperti shqyrtues paraqet vlerësimin në vijim.

Vlerësimi mbështetet, ndër të tjera, në nenin59 dhe nenin 72 të LPP-së, si dhe në nenet 38 dhe 40 të Rregullores, në masën që këto dispozita janë të zbatueshme për çështjen konkrete.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka përcaktuar kërkesën që Operatori Ekonomik të paraqesë katalogun, prospektin ose fletën teknike zyrtare të prodhuesit për pompën termike dhe pajisjet përcjellëse të ofruara.

Sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, dokumentacioni teknik është kërkuar me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë së pajisjeve të propozuara me specifikimet teknike të përcaktuara nga AK. Dokumentacioni përkatës është dashur të përmbajë, së paku, emrin e prodhuesit, markën, modelin, kapacitetin, karakteristikat teknike, efikasitetin energjetik dhe të dhënat e tjera relevante të pajisjes së ofruar, sipas natyrës së pajisjes dhe kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Nga krahasimi i kërkesave të Dosjes së Tenderit me dokumentacionin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, konstatohet se ky operator ka paraqitur katalogun për pompën termike, por nuk rezulton të ketë dorëzuar katalogun, prospektin ose fletën teknike zyrtare të prodhuesit për pajisjet përcjellëse të kërkuara në Dosjen e Tenderit.

Rrjedhimisht, dokumentacioni i paraqitur nuk mundëson verifikimin e plotë dokumentar të karakteristikave teknike dhe të përputhshmërisë së pajisjeve përcjellëse me kërkesat e përcaktuara nga AK.

Eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa për paraqitjen e katalogut ose fletës teknike të prodhuesit për pompën termike dhe pajisjet përcjellëse përbën një kërkesë të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, e cila duhet të shqyrtohet dhe të zbatohet në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë operatorëve ekonomik.

Në këtë drejtim,neni 40, paragrafi 40.2, i Rregullores Nr. 001/2022, versioni konsoliduar 11.11.2024 përcakton se ofertat duhet të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk mund të ndryshojë, modifikojë ose të heqë kërkesat e përcaktuara paraprakisht gjatë procesit të vlerësimit.

Duke u mbështetur në gjendjen faktike të përshkruar dhe në dispozitat e lartcekura, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor lidhur me mungesën e katalogut ose fletës teknike zyrtare për pajisjet përcjellëse është i bazuar në aspektin e konstatimit të mungesës së dokumentacionit të kërkuar.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues para publikimit njoftimit mbi vendimin B58, bazuar në nenin nenit 72 të LPP-së, ka mundur të kërkoj sqarimet e nevojshme, dhe të bëje verifikimin e së njejtes, rrjedhimisht pretendimi **është i bazuar**.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet Pjesërisht e bazuar, të anuloj Njoftimin mbi Vendimin B58, dhe lënda të kthehet në Rivleresim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" EJONA " SH.P.K.**

Bekim Shabani